

Informacion

Vendos dhe firmos

NË KOMUNË

Është i mundur deklarimi dhe regjistrimi i zgjedhjes personale për dhurimin e organeve, direkt pranë Komunës në momentin e kërkimit ose rinovimit të Kartës së Identitetit thjesht duke firmosur një formular. Këtë e parashikon projekti rajonal “ Një zgjedhje e përbashkët” që zgjeron mundësitë e regjistrimit të zgjedhjes për dhurimin e organeve.

Rajoni Toscana bën të mundur realizimin së bashku me Anci Toscana, Federsanità Anci, Aido e Qendrën Kombëtare të Trapianteve.



Referencat ligjore

L.91/1999)

L. di conversione 25/2010 “Milleproroghe”

KU e SI

Bëhet deklarimi i zgjedhjes për dhurimin

Nëse jemi në moshë madhore, mund të manifestojmë zgjedhjen tonë për dhurimin apo jo të organeve:

- në Komunë, duke firmosur një formular të thjeshtë në momentin e përtëritjes së kartës së identitetit. Të dhënat e marra nuk paraqiten në dokumentin e identifikimit;
- pranë sporteleve të posaçme të Ndërmarrjeve Shëndetësore lokale duke plotësuar e firmosur një formular;

- duke plotësuar e firmosur librezën e Shoqatës Italiane të dhuruesve të organeve, indeve e qelizave (Aido);
- me një deklaratë në letër të thjeshtë me të gjitha të dhënat personale, me datë dhe firmë, të cilën duhet ta mbajmë me vete (në portofol).

Deklarimi i dëshirës për të dhuruar është i regjistruar në Sistemin informativ të trapianteve (Sit) me përjashtim të deklaramit në kartë të thjeshtë i konsideruar gjithashtu i vlefshëm në bazë të ligjit.

Numri jeshil rajonal 800 556060

Informacione

PYETJE DHE PËRGGJIGJE

PSE DHUROJMË

Sepse kush është në pritje të një organi shpreson vetëm tek dhurimi për të vazhduar të jetojë. Shpesh nuk mendojmë për këto probleme, por kush ka nevojë mendon çdo ditë.

NJË ZGJEDHJE E VETËDIJSHME

Duke shprehur vullnetin për dhurimin e organeve sa jemi në jetë, bëjmë një zgjedhje të ndërgjegjshme Mund të informohemi, të flasim në familje për të bashkëndarë vendimin tonë dhe të jemi të sigurt që ky vendim të respektohet.

GARANCITË

Ligji garanton vullnetin e lirë në zgjedhjen e dhurimit.

Mund të zgjedhim për dhurimin apo mos dhurimin dhe të ndryshojmë mendim në çdo moment.

Nëse nënshkruajmë zgjedhjen tonë për dhurimin, familjarët nuk mund të kundërshtojnë.

Nëse nënshkruajmë zgjedhjen tonë për mosdhurimin nuk kryhet asgjë (nuk ka heqje organesh).

Nëse nuk shprehemi, heqja e organeve është e mundur vetëm në rast se familjarët që kanë të drejtë nuk kundërshtojnë. Në çdo rast nuk ekziston pëlqimi ose miratimi në heshtje

KUR KRYHET DHURIMI

Vetëm kur është bërë çdo gjë e mundur për të shpëtuar jetën e pacientit , por truri nuk funksionon më dhe nuk mund të funksionojë për shkak të shkatërrimit të plotë të qelizave cerebrale, domethënë kur është pranuar vdekja e trurit, ose vdekja cerebrale që në ndryshim me gjëndjen e komës është një gjëndje definive dhe e pakthyeshme.

Tre specialistë (një mjek legal, një rianimues dhe një neurolog) kryejnë hetimet klinike për të stabilizuar të paktën për 6 orë rresht mungesën e reflekseve cerebrale, si për shembull reagimin nga stimulimet e dhimbjeve, frymëmarrja e lirshme, gjëndje koshiente, çdo lloj aktiviteti elektrik të trurit.

ANONIMATI DHE MOSPAGIMI

Nuk është e mundur të dihet as emri i dhuruesit as ai i pranuesit, sepse organet janë të regjistruara në regjistër në bazë të kushteve të urgjencës dhe nga përshtashmëria klinike dhe imunologjike e personave në pritje të trapianteve.

Është e paligjshme shitja dhe blerja e organeve njerëzore : dhurimi është gjithnjë falas dhe anonim. Kostot e trapiantit janë në ngarkim të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar.

DHURIMI I ORGANEVE DHE INDEVE DUKE QENË AKOMA GJALLË

Mund të dhurohen veshka dhe një pjesë e mëlçisë, mushkëria, pankreasi dhe zorra e trashë, qelizat staminale (palca, gjaku periferik dhe gjaku i kordonit), lëkura, plaçenta dhe segmente kockash.

Të gjitha organet e tjera dhe indet, me përjashtim të trurit dhe gonadeve mund të dhurohen vetëm pas vdekjes.

FETË

Besimet kryesore fetare janë në favor të dhurimit të organeve. Të gjitha porosisin që dhurimi të jetë frut i një zgjedhjeje të lirë dhe jo të detyrueshme.